

Nr. 4937/A



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIRËQENIES
SOCIALE DHE RINISË
MINISTRI

UDHËZIM

Nr. 18, datë 30.08.2016

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 277, DATË 18.06.1997, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, "PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBRIT, TË
NDRYSHUAR"**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Shqipërisë, në Ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar, të pikës 16 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 277, datë 18.06.1997, "Për përfitimet nga statusi i të verbrit", i ndryshuar:

U D H Ë Z O J:

1. Masa e përfitimit për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4, të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 277, datë 18.06.1997 të ndryshuar, bëhet 11.510 (njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e dhjetë) lekë në muaj. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i të verbrit.
2. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 Shtatori i vitit 2016 dhe përballohen me fondet akorduara për vitin 2016, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.
3. Udhëzimi nr. 24, datë 20.08.2015 i Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga 01.09.2016.


Blendi Klosi
MINISTËR

